



FAKULTETI I KOMUNIKIMIT MASIV DHE GAZETARISË
PROGRAMI: KOMUNIKIM MASIV DHE GAZETARI - MASTER

PUNIM MASTER

VLERAT E LAJMIT
NË EDICIONET E LAJMEVE QENDRORE
NË RTK, KTV DHE ATV - QASJE KRAHASUESE

Mentor:
Prof. Ass. Dr. Gazmend Abrashi

Kandidate:
Erona Salihu

Prishtinë, 2022

Deklarata e autorësisë

Unë Erona Salihu deklaroj se punimi është shkruar nga unë, të gjitha burimet të cilat janë përdorur në punim i kam cituar në mënyrën e duhur. Dhe me vetëdije të plotë nuk kam përdorë asnjë burim pa e cituar.

Përgjegjësin nëse dëshmohet e kundërta e barti unë, si autore e këtij punimi.

Letër mirënjohje dhe falenderimi

Ndonëse shkollimi im i mesëm nuk përkon aspak me fushën që zgjedha të studiojë në vitin 2016, sot ndihem jashtëzakonisht mirë që po e realizojë ëndrrën time. Duke e ditur pasionin që kisha si e vogël për gazetari, nuk e kam pas fare të vështirë zgjedhjen e institucionit ku do të studioja.

Kur bëhej fjalë për studime cilësore në fushën e medias, Kolegji AAB nuk kishte si të mos përmendej. Kuadrot që kishte prodhuar ndër vite, infrastruktura dhe cilësia përgjatë studimeve ishin dhe vazhdojnë të jenë siguri e suksesit për të ardhmen. Fillimisht pretendoja të ndjek vetëm studimet bachelor, por shikëputja nga AAB nuk ishte opion i imi më. Në përfundim të vitit të tretë të studimeve, fillova praktikën në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun të Kolegjit AAB, aty ku sot jam e punësuar. Dëshira për avancim të mëtutjeshëm profesional më bëri që të regjistrojë edhe nivelin master të këtij fakulteti.

Në përmbyllje të kësaj letre, u jam mirënjohëse juve komision i nderuar dhe mentorit tim Prof. Ass. Dr. Gazmend Abrashi që ma mundësuat që ta mbroj këtë temë dhe të mbaroj nivelin master me diplomim të suksesshëm. Dua të falenderojë stafin akademik dhe atë administrativ për sjellje profesionale. Ndërsa, në fund por jo më pak të rëndësishëm e konsideroj familjen time të cilëve edhe ua dedikoj këtë punim. Suksesi im me përlësinë më të madhe ju përket juve!

Abstrakti

Respektimi i kritereve që parashihet me vlerat e lajmit apo vlerat e lajmeve, është shumë i rëndësishëm në media e sidomos në televizion, mirëpo një kontekst si Kosova ku kemi ngjarje dhe lajme të cilat mund t'i tejkalojnë edhe elementet dhe kriteret e vlerave të lajmit, është shumë me rëndësi që këto kritere dhe vlera të respektohen, me të vetmin qëllim mirë informimi i shikuesve dhe dëgjuesve tanë. Ndryshimi i sistemeve politike dhe faza e tranzicionit në të cilën po kalon vendi ynë, dhe hapja drejt një shoqërie demokratike, bëri që të kemi shumë mundësi për t'u informuar, mirëpo, me këtë edhe rreziqe për tu mos informuar në mënyrën profesionale. Zbatimi i vlerave të lajmit në edicionet e lajmeve në televizionet nacionale në Kosovë ka të bëjë me mënyrën e konsumit të produktit mediatik, në këtë rast të lajmit. Nëpërmjet metodës së vëzhgimit kemi hulumtuar tri televizionet nacionale në Kosovë, Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), Kohavisionin (KTV) dhe A Televizionin (ATV), hulumtimi ka zgjatë për një periudhë një mujore. Punimi konstaton se në përgjithësi këto televizione i respektojnë kriteret e vlerave të lajmit, duke ofruar lajme dhe informacione aktuale dhe që kanë interesin e publikut për t'i ndjekur.

Fjalë kyçe: vlerat e lajmit, lajm, edicion i lajmeve, informacion, televizion.

Abstract

Respecting the criteria provided by news values is very important in the media and especially on television, but the example of Kosovo where we have events and news that can exceed the elements and criteria of news values, it is very important that these criteria and values are respected, with the sole purpose of informing our viewers and listeners. The change of political systems and the transitional phase that our country is going through, and the opening towards a democratic society, made us have many opportunities to be informed, but there are also risks of not being informed in a professional way. The application of news values in news editions on national televisions in Kosovo has to do with the way of consuming the media product, in this case the news. Through the observation method, research was done with three national televisions in Kosovo, Radio Television of Kosovo (RTK), Kohavision (KTV) and A Television (ATV), where the research lasted for a period of one month. The research finds that, in general, these televisions respect the criteria of news values, offering current news and information and have the public's interest in watching them.

Keywords: news values, news, newscast, information, television.

Hyrje

Respektimi i kriterëve teorikë të vlerave të lajmit është shumë sfiduese për shumë gazetarë e redaksi të lajmeve në media, në bazë të cilave kriterë vendosin ta publikojnë një lajm. Cila është metoda e seleksionimit që e përdorin, gjykimet që bëhen kur gazetarët zgjedhin lajmet, deri tek vendimarrja, publikimi në media në rastin tonë në televizion, të lajmit. Vendimarrja gazetareske është një fenomen shumë kompleks që varet nga një mori parakushtesh të cilat janë të vështira për t'u trajtuar dhe për t'ju dhënë përgjigje të menjëhershme. Sipas Shoemaker dhe Reese (1996), rëndësia, interesi njerëzor, konflikti/polemika, pazakonshmëria, kohëzgjatja dhe afërsia janë faktorët kryesorë të medias, profesionistët marrin parasysh gjatë mbledhjes dhe përpilimit të lajmeve, dhe kjo mund të jetë për shkak të një audiencë të madhe që dëshiron të shohë dhe të dëgjojë atë (Muhammad Ittefaq, 2018, f.82).

Kur kanë shumë e shumë aktivitete/ngjarje të cilat kanë informacione të nevojshme për tu publikuar si lajme. Në kontekstin e gazetarisë, çka paraqet lajm, cilave pyetje ju përgjigjet një lajm? Faktor i rëndësishëm është koha sepse nëse nuk publikohet brenda kohës kur audiencia ka interes ta akceptoj, atëherë ai e humbet vlerën e tij. Ka edhe element të tjerë që duhet t'i ketë një lajm si: të raportohen shpejt, saktë dhe me ndershmëri, në mënyrë të ekuilibruar dhe të paanshme.

Vlerat e lajmit sipas Joseph R. Dominick (2010), janë formësuar nga tradita, nga politika redaksionale, nga faktori ekonomik dhe tani së fundmi edhe nga revolucioni digjital. Megjithatë, shumica e gazetarëve janë akoma të një mendjeje kur bie fjala për pesë elementët thelbësorë që i karakterizojnë ngjarjet që përbëjnë lajm:

- a. aktualiteti;
- b. afërsia;
- c. spikatja;
- d. ndikimi;
- e. interesi njerëzor.

Nisur edhe nga element të tjerë redaksia dhe gazetarët kanë mundësi që ngjarjen apo informacionit të cilin e publikojnë të kenë mundësi ta verifikojnë, ta hulumtojnë, të kenë mundësi të përfshijnë të gjithë individët të cilët janë përgjegjës për atë çështje dhe në këtë kuadër e bën më të plotë, më përmbajtësor dhe më të rëndësishëm si për televizionin si medium sepse pasqyron punën kryesore ditore në aspektin gazetaresk, ashtu edhe për audiencën sepse ka mundësi të informohet për të gjitha zhvillimet ditore, e për të cilat s'ka pas mundësi të informohet gjatë ditës.

Është në përgjegjësinë e redaksisë apo diskut informativ të vendos se si do të bëjë radhitjen e kronikave në edicionin qendror të lajmeve, pra hierarkinë e edicionit të lajmeve, natyrisht si në të gjitha edicionet e lajmeve duhet të këtë një metodë të seleksionimit dhe përzgjedhjes së lajmeve të cilat janë në interes të qytetarëve, gjithnjë me qëllim të ndjekjes së tij, prej këtyre të fundit. Është esenciale sidomos në edicionet qendrore të lajmeve të këtë lajme/kronika me përmbajtje sociale, nga realiteti me të cilin përballen qytetarët e vendit dhe mos të ndodh që një edicion i lajmeve të përmbajë vetëm lajme dhe informacione të karakterit nacional politikë, ekonomikë dhe mos të trajtoj problematika të ndryshme me të cilat përballen qytetarët.

Natyrisht, rëndësia dhe pesha e ngjarjeve të caktuara bën që të ndryshohet jo rallë herë radhitja e kronikave në edicionet e lajmeve qendrore, por edhe në raste të tilla prapëseprapë ka një radhitje të lajmeve. Dhe këtë çështje do ta trajtojnë me realizimin e punimit, pra, të monitorojmë edicionet qendrore të lajmeve në tri televizionet nacionale në vendin tonë, RTK, KTV dhe Klan Kosova, dhe të shohim kuantitativisht se sa lajme me përmbajtje politike, sociale, ekonomike, kulturore dhe sportive, transmetojnë në edicionet e tyre të lajmet qendrore.

Në bazë të kësaj mund të kemi një pasqyrë më të kjartë të edicioneve qendrore të lajmeve, në kuptim të asaj se sa kemi lajme nga këto rubrika që i kemi cekur më lartë. Natyrisht, është shumë e rëndësishme të kemi të përfshirë edhe kryeredaktorët e këtyre televizioneve, dhe t'i pyesim për mënyrën e përzgjedhjes së lajmeve për edicionet qendrore informative.

Qëllimi i punimit

Qëllimi i punimit është që në pjesën teorike të rishikimit të literaturës të paraqet çka është lajmi, se çfarë paraqet një lajm, çka duhet të përmbajë një lajm, cilave pyetje duhet t'i përgjigjet lajmi. Në pjesën e hulumtimit do të monitoroj edicionet qendrore të lajmeve në tri televizionet nacionale në vendin tonë, RTK, KTV dhe Klan Kosova, në aspektin e përmbajtjes së lajmeve (vlerës së lajmeve) të cilat i transmetojnë në edicionet qendror të lajmeve. Të shohim se sa kronika të edicionit të lajmeve qendrore janë me përmbajtje politike, sociale, ekonomike, kulturore dhe sportive, dhe nga kjo pastaj mund të nxjerrim krahasime dhe konkluzione, pse ka një tendencë të tillë të formulimit/hierarkisë të edicionit informativ me atë hierarki tematike të lajmeve pasi t'i kemi analizuar ato. Njëri televizion që e kemi marrë si rast studimi është publik dhe dy të tjerët janë privat dhe krahasimi i përmbajtjes së edicioneve qendrore të lajmeve do të na ofroj të dhëna të vlefshme, për të parë edhe politikën editoriale të tyre si mediume.

Objektivat

Ky punim i ka disa objektiva:

1. Të tregoj për vlerat që duhet t'i ketë një lajm.
2. Të tregoj për llojin e kronikave të trajtuara në lajmet qendrore.
3. Të tregoj për numrin e lajmeve të publikuara në bazë të tematikave të trajtuara.
4. Të tregoj për mënyrën e seleksionimit të lajmeve.
5. Të tregoj për kohë zgjatjen mesatare të kronikave në lajmet qendrore.
6. Të krahasoj dallimin në hierarkinë e edicionit qendror të lajmeve ndërmjet televizionit publik dhe televizioneve private.

Pyetjet kërkimore

1. Cilat kategori vlerash të lajmit dominojnë në edicionet e lajmeve qendrore?
2. Çfarë kategorie të vlerave të lajmit janë përmbajtje tematike edicionin e lajmeve qendrore?
3. Cila është metoda e hierarkisë së lajmeve në edicionin qendror?
4. Mesatarisht sa zgjasin kronikat e lajmeve në edicionin qendror?
5. Ku qëndron dallimi në strukturën e edicionit të lajmeve në televizionin publik dhe atyre privat.

Metodologjia

Për realizimin e punimit do të përdorim dy metoda të kombinuara, kuantitative dhe krahasuese si dhe realizimin e intervistave me kryeredaktorët e televizioneve të marra për hulumtim. Metoda kuantitative na shërben për të përcjellë edicionin qendror të lajmeve dhe për të nxjerrë të dhënat të cilat na duhen, që i kemi parashtruar si pyetje kërkimore dhe pastaj me anë të metodës statistikore të bëhet përpunimi i tyre, krahasimi dhe interpretimi i tyre. Hulumtimi mendohet të zgjasë 1 muaj (15.12.2021-15.01.2022) dhe brenda kësaj periudhe të shikohen edicionet e lajmeve dhe të merren të dhënat.

Rëndësia e temës

Punimi është i një rëndësie të veçantë, pikërisht për faktin se kemi të bëjmë me veprimtarinë kryesore gazetareske në një medium më konkretisht në televizion, edicioni qendror paraqet gjithë punën e redaksisë informative dhe jo rastësisht mendohet se në edicionin qendror shihen të gjitha anët profesionale dhe teknike të përgatitjes së kontentit gazetaresk në një mediumi. Hierarkia e lajmeve në edicionin qendror është tematikë në vete dhe në të shumtën e rasteve paraqet sfidë për deskun informativ në kuptim të asaj se cili lajm është më i rëndësishëm dhe që i përgjigjet interesave të

qytetarëve për ta ndjekë televizionin e caktuar për tu informuar. Në këtë kuadër një temë e tillë është shumë e rëndësishme dhe shumë aktuale për tu hulumtuar.

Rezultatet e pritura

Me realizimin e këtij punimi synojmë të arrijmë tek rezultatet e synuara siç janë: të tregojmë për vlerat e lajmit, çka është lajmi, profilizimi i kronikave të transmetuara në edicionin qendror të lajmeve, cila është metoda e hierarkisë së lajmeve në edicionin qendror, mesatarisht sa zgjasin kronikat e lajmeve në edicionin qendror, dhe ku qëndron dallimi në strukturën e edicionit të lajmeve në televizionin publik dhe atyre privat. Pra, synojmë të identifikojmë profilin e tematik të kronikave dhe në bazë të kësaj mund të arrijmë në përfundim se sa redaksitë e televizioneve e vejnë interesin e qytetarëve në rend të parë për tu informuar.

Bibliografia

- Abrashi, G., & Sallauka, U. (2022). Use of Information Technology in Academic Library Practice. *The International Information & Library Review*, 54(4), 380–386.
<https://doi.org/10.1080/10572317.2022.2124834>
- Abubakar, T. A. (2020). News Values and the Ethical Dilemmas of Covering Violent Extremism.
<https://openaccess.city.ac.uk/id/eprint/22215/1/Accepted%20version%20of%20news%20values%20piece.pdf>
- Basics of Editing. <http://www.rapodar.ac.in/pdf/elearn/JournalismSem4Notesforstudents.pdf>
- BEDNAREK, M. & CAPLE, H. The Discourse of News Values HOW NEWS ORGANIZATIONS CREATE NEWSWORTHINESS
https://mail.google.com/mail/u/0?ui=2&ik=e2bc9dd017&attid=0.9&permmsgid=msg-f:1719385449004774668&th=17dc7bf4c7e7b50c&view=att&disp=inline&realattid=f_kxa6np057
- Bednarek, M. (2015). Voices and values in the news: News media talk, news values and attribution.
- Berisha, I. (2010). *Zhanret dhe teknikat e gazetarisë*. Prishtinë. Kolegji AAB.
- British National Corpus. <http://www.natcorp.ox.ac.uk/>
- Burimet dhe gazetari
- Caple, H. (2018). *News Values and Newsworthiness*.
https://www.academia.edu/44015295/News_Values_and_Newsworthiness
- Caple, H. Bednarek, M. (2012). 'Value added': *Language, image and news values*.
https://www.academia.edu/1818445/2012_Value_added_Language_image_and_news_values
- Dhima, A. (2013). *Antropologji e komunikimit*. Tiranë.
- E. Wangh, Seoop. *WHAT IS NEWS?* https://us.sagepub.com/sites/default/files/upm-assets/9722_book_item_9722.pdf
- Ethical Journalism.
- Fang, I. (1991). *Writing Style Differences in Newspaper, Radio, and Television News*.
<https://writing.umn.edu/widgrants/assets/pdf/publications/Irving%20Fang.pdf>
- Fisher, C. (2018). News Sources and Journalist/Source Interaction.
https://www.researchgate.net/publication/327392908_News_Sources_and_JournalistSource_Interaction

Gruhl, D. & Bender, W. (2000). A new structure for news editing.

https://www.researchgate.net/publication/220354298_A_new_structure_for_news_editing

Harcup, T. O'Neill, D. (2016). *What is news?* https://www.academia.edu/34884359/What_is_news

<https://atvlive.tv/>

https://nytco-assets.nytimes.com/m/NYT_Ethical_Journalism_0904-1.pdf

<https://www.kohavision.tv/per-ne/>

<https://www.reporter.al/manualidrejtewise/BURIMET%20DHE%20GAZETARI.html>

https://www.researchgate.net/publication/263555431_Local_tv_news_content_and_the_bottom_line

https://www.rtklive.com/pages/files/ligji_rtk.pdf

Ivancheva, Th. *News Values – Revised*. <https://core.ac.uk/download/pdf/12037624.pdf>

Jorgensen, K.W. & Hanitzsch, Th. (2009). *The Handbook of Journalism Studies*.

<http://keralamediaacademy.org/wp-content/uploads/2015/02/Handbook-of-Journalism-Studies.pdf>

JOY, K. J. *News values*.

https://littleflowercollege.edu.in/upload/e_contents/files/d38d2873cf75b515a9f5eea65ae0341c.pdf

Leon, Ch.P. *That's the Way It Is A History of Television News in America*.

https://press.uchicago.edu/books/excerpt/2015/De_Leon_Thats_Way_It_Is.html

LIGJI Nr. 04/L-046 PËR RADIOTELEVISIONIN E KOSOVËS

[Mast](#), J. [Temmerman](#), M. (2021). *What's (The) News? Reassessing "News Values" as a Concept and Methodology in the Digital Age*.

<https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/1461670X.2021.1917445>

Meissner, N. (2015). *50 years on: Galtung and Ruge's news value factors revisited in online audience building for independent films*.

<https://firstmonday.org/ojs/index.php/fm/article/view/5850/4408>

Metodat e mbledhjes së lajmeve. <http://www.tpub.com/journalist/56.htm>

News as History. Nga libri *The News in America*.

<https://www.degruyter.com/document/doi/10.4159/harvard.9780674182578.c4/html>

Newsroom set up and functions: Print and Online Media.

<https://egyankosh.ac.in/bitstream/123456789/57074/1/Unit%203.pdf>

Ogbonna, S. (2022). *NEWS REPORTING GUIDE New*.

https://www.researchgate.net/publication/357767144_NEWS_REPORTING_GUIDE_New

Producing TV news items and reports. https://vision-videoschool.eu/?page_id=882

- Saliu H. & Lljunji V. (2022). Cultural Diplomacy of Kosovo after the Declaration of Independence. *Information & Media*, 93, 62-76. <https://doi.org/10.15388/Im.2022.93.61>
- Saliu, H. (2021). The specifics and complexity of EU public diplomacy. *Druzboslovne Razprave*, XXXVII(96–97), 189–207. <https://www.sociolosko-drustvo.si/wp-content/uploads/2021/09/DR96-97-Saliu-WEB.pdf>
- Saliu, H. (2022). Public Diplomacy or Public Glocalization? Rethinking Public Diplomacy in the post-Truth Era. *Vestnik Moskovskogo universiteta. Seriya 10. Zhurnalistika*, 1, 157-175. [DOI: 10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175](https://doi.org/10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175)
- Saliu, H. (2022). Rethinking Media Diplomacy and Public Diplomacy Towards a New Concept: Digital Media Diplomacy. *Online Journal Modelling the New Europe*, 39, 1-24. DOI: [10.24193/OJMNE.2022.39.01](https://doi.org/10.24193/OJMNE.2022.39.01)
- Saliu, H., Bicaj, A. (2022). The Digital Competence of Future Teachers in Kosovo. In L. Tomczyk & L. Fedeli, (eds), *Digital Literacy for Teachers. Lecture Notes in Educational Technology*. Springer, Singapore. (275-290). https://doi.org/10.1007/978-981-19-1738-7_15
- Saliu, H., Rexhepi, Z., Shatri, S. & Kamberi, M. (2022). Experiences with and risks of internet use among children in Kosovo. *Journal of Elementary Education*, 15(2), 145–164. <https://doi.org/10.18690/rei.15.2.145-164.2022>
- Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në programet e RadioTelevizionit të Kosovës. https://www.rtklive.com/pages/files/standardet_profesionale.pdf
- Tse, H.Ch. Spiezio, R. *News Values Revisited: A Comparison between Citizen and Mainstream Media in Hong Kong* [News Values Revisited A Comparison between Citizen and Mainstream Media in Hong Kong%20\(2\).pdf](https://www.researchgate.net/publication/282801886_News_values_revisited_a_comparison_between_citizen_and_mainstream_media_in_hong_kong%20(2).pdf)
- Web faqja e Kohavisionit.
- Web faqja e televizionit ATV.
- Welbers, K. & Atteveldt, W. (2015). News selection criteria in the digital age: Professional norms versus online audience metrics. https://www.researchgate.net/publication/282801886_News_selection_criteria_in_the_digital_age_professional_norms_versus_online_audience_metrics
- What is news, news value sources of news. <https://egyankosh.ac.in/bitstream/123456789/7497/1/Unit-1.pdf>
- Why reporting for various media differ. <http://osou.ac.in/eresources/Different%20types%20of%20media%20and%20reporting.pdf>
- Yanich, D. (2013). Local tv news, content, and the bottom line.